

Biografia

Eloida Goxhi është anëtare e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e zgjedhur nga Mbledhja e Përgjithshme e Prokurorëve si përfaqësuese e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat. Ajo është diplomuar për Drejtësi pranë Universitetit të Tiranës dhe është diplomuar Prokurore nga Shkolla e Magjistraturës.

Përvoja e saj e punës fillon me emërimin si Prokurore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, për të vazhduar me Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat. Nga Janari i vitit 2016 deri në Dhjetor të vitit 2020 ka ushtruar detyrën e Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat. Prej muajt Shkurt të vitit 2021 ushtron detyrën e anëtares së Këshillit të Lartë të Prokurorisë.